



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 31.03.2023

Nr: 38

Ora: 14:20

**VENDIM**

**PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 40, DATË 30.03.2023  
PARAQITUR NË KQZ NGA Z. MEHMET NELAJ**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 31.03.2023, me pjesëmarrjen e:

<b>Koli BELE</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** z. Mehmet Nelaj

**OBJEKT:** Kundërshtim i vendimit nr. 17, datë 27.03.2023, të KZAZ-së nr. 90 të bashkisë Sarandë

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, gërma "c", 123/1, 126 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

### **Rrethanat e çështjes:**

1. Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.
2. Në zbatim të parashikimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor, si dhe të Udhëzimit nr. 01, datë 18.01.2023 për “Përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, z. Mehmet Nelaj ka depozituar në datën 07.03.2023 dokumentacionin e kandidimit të tij si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak Sarandë, në KZAZ nr. 90 të kësaj bashkie.  
  
Pjesë e dokumenteve të tij ishte vërtetimi nga njëسيا e qeverisjes vendore ku vërtetohej zotërimi i mandatit të tij si këshilltar aktualisht në Këshillin Bashkiak Sarandë.
3. Me vendimin nr. 17, datë 27.03.2023, KZAZ nr. 90 Sarandë vendosi refuzimin e kërkesës për regjistrimin si kandidat të z. Mehmet Nelaj, për shkak të mungesës së komitetit nismëtar, që është i vetmi që mund të kërkojë regjistrimin e një kandidati të pavarur pranë KZAZ.
4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur kërkesë ankimore z. Mehmet Nelaj, ku pretendon se dokumentët e dorëzuara nga ana e tij janë dokumentet tip të përdorura për regjistrimin e kandidatëve në zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2019, pasi nuk ishte në dijeni të formatit të dokumenteve të kërkuara për zgjedhjet vendore të 14 majit 2023. Ankuesi pretendon se fakti që zotëron mandatin e vlefshëm të këshilltarit bashkiak në bashkinë Sarandë, e përjashton nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të nenit 70 ku flitet për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Për këto arsye ankuesi kërkon regjistrimin e tij si kandidat për Këshillin Bashkiak Sarandë.
5. Kërkesa ankimore iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Koli Bele. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 31.03.2023, ora 14:00.
6. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
  - Kërkesën ankimore nr. 40, datë 30.03.2023;

- Vendimin nr. 17 datë 27.03.2023 të KZAZ nr. 90 Sarandë.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

#### **KAS-i konstatoi:**

1. Rrethanat e çështjes provojnë qartë se ankuesi Mehmet Nelaj ka kërkuar të regjistrohet si kandidat i pavarur, pa kaluar nëpër procedurën e regjistrimit fillimisht të një "komiteti nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin", sikurse kërkon pika 3 e nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Ankuesi ka zgjedhur këtë rrugë procedurale mbështetur në praktikën e regjistrimit të kandidatëve në zgjedhjet për qeverisjen vendore të vitit 2019, biles, siç e pohon vetë, duke përdorur dokumentacionin tip për regjistrimin e kandidatëve në ato zgjedhje.
2. Pika 3 e nenit 70 të Kodit Zgjedhor përcakton se afati për regjistrimin e komitetit nismëtar është "jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve". KZAZ-ja nr. 90 Sarandë ka konstatuar faktin juridik të mungesës së komitetit nismëtar dhe, mbi këtë bazë, ka refuzuar regjistrimin e kandidatit. KZAZ-ja nr. 90 nuk mund t'i jepte mundësinë ankuesit që, në procedurë korrigjimi të dokumentacionit, të plotësonte këtë mangësi. Subjekti që kërkon regjistrimin e kandidatit të pavarur është komiteti nismëtar dhe jo anasjelltas. Vetëm komiteti nismëtar mund të vërë në lëvizje KZAZ-në për regjistrimin e kandidatit. Kandidati vetë nuk e ka këtë tagër, sepse Kodi Zgjedhor nuk e njeh mekanizimin e vetkandidimit.
3. Pretendimi se zotërimi i një mandati të vlefshëm këshilltari bashkiak e bën të panevojshëm regjistrimin në zgjedhje të komitetit nismëtar, sepse bën të panevojshme mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse nuk qendron. Ky pretendim mbështetet mbi një lexim të gabuar të dispozitës së pikës 4 të nenit 70 të Kodit Zgjedhor. Pika 4 çliron kandidatin me mandat vetëm nga detyrimi për të mbledhur nënshkrime mbështetëse nga zgjedhësit, por nuk vendos një procedurë të ndryshme regjistrimi për ta.

4. Procedura e regjistrimit bëhet e qartë edhe nga udhëzimi i Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, sipas të cilit regjistrimi i kandidatit të pavarur kërkohet domosdoshmërisht nga komiteti nismëtar (nenet 5 dhe 6 të udhëzimit).
5. Fakti se ankuesi është orientuar në procedurën e regjistrimit nga praktika e zgjedhjeve të mëparshme dhe jo nga kuadri ligjor i qartë dhe preciz, nuk mund të konsiderohet shkak për “tolerancë”. Si KZAZ-ja nr.90, ashtu dhe KAS-i nuk kanë asnjë hapësirë për diskrecion në një situatë të tillë, sepse neni 11 i Kodit të Procedurave Administrative nuk lejon ushtrimin e diskrecionit në tejkalim të kufijve të ligjit (shkronja “b” e nenit 11).
6. Për më tepër, KAS-i nuk mund të prishë vendimin e KZAZ-së, sepse prishja e vendimit do të nënkuptonte se KZAZ-ja nr. 90 ka shkelur ligjin kur ka vendosur mosregjistrimin e ankuesit në zgjedhje. E vërteta është se KZAZ-ja ka zbatuar me përpikëri ligjin kur ka ndërmarrë këtë akt. Udhëzimi i Komisionerit nr. 1, datë 18.01.2023 i kërkon shprehimisht KZAZ-së që kur shqyrton dokumentat e kandidimit të verifikojë paraprakisht “nëse Komiteti Nismëtar që propozon një kandidat është regjistruar”, apo jo (shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7). Prandaj KAS-i duhet të rrëzojë kërkesën ankimore nr. 40 dhe të lërë në fuqi vendimin nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ-së nr. 90, Sarandë.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 143 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

#### **V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 40, datë 30.03.2023 të paraqitur nga z. Mehmet Nelaj.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ-së nr. 90, Bashkia Sarandë.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Koli BELE - Relator (Kundër)**

**Elvin LAKO - Anëtar**

**Elvis ÇEFA - Anëtar**

**Ilirjan RUSMALI - Anëtar**

**Ledio BRAHO - Anëtar (Kundër)**

## MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 40 të paraqitur nga z. Mehmet Nelaj me objekt *“Kundërshtimin e vendimit nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ Nr. 90, Sarandë”*, ne, anëtarët në pakicë, duke mos qenë dakord me konkluzionet dhe argumentet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) jemi të mendimit se KAS duhet të pranonte ankimin e paraqitur nga z. Mehmet Nelaj dhe për rrjedhojë të ndryshonte vendimin nr. 17, datë 27.03.2023 të KZAZ Nr. 90, ndaj paraqesim, në vijim, argumentet tona për këtë qëndrim.
2. Rezulton i provuar fakti se ankimuesi Mehmet Nelaj është aktualisht anëtar i Këshillit Bashkiak të Bashkisë Sarandë, mandat ky i fituar nga kandidimi në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.
3. K.Zgjedhor, në nenet 63 e vijues të tij rregullon regjistrimin e subjekteve zgjedhore. Neni 63 i K.Zgjedhor, ndër të tjera, parashikon se:
  - “1. Subjekt zgjedhor është një parti politike ose një koalicion partish politike, të cilët paraqesin listë kandidatësh, sipas rregullave që përcaktohen në këtë Kod.*
  - 2. Subjekt zgjedhor mund të jetë edhe një shtetas shqiptar me të drejtë vote, i cili propozohet si kandidat për deputet apo për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Kod.***
  - 3. Kandidat është shtetasi që plotëson kushtet e parashikuara në nenet 45 dhe 69 të Kushtetutës dhe që regjistrohet si kandidat për deputet në KQZ ose si kandidat për kryetar bashkie ose për këshillat vendore në KZAZ”.*
4. Nga formulimi i nenit 63 të sipërcituar, kuptojmë që kemi të bëjmë me një dispozitë referuese për secilin nga llojet e subjekteve zgjedhore. Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, ankimuesi e klasifikon veten si subjekt zgjedhor i propozuar si kandidat për organet e qeverisjes vendore nga një grup zgjedhësish.

5. Neni 70 i K.Zgjedhor përcakton mënyrën e regjistrimit për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, duke parashikuar konkretisht se:

*“1. Një grup zgjedhësish me banim në zonën zgjedhore kanë të drejtë të propozojnë një kandidat për kryetar të bashkisë ose një kandidat për këshillin vendor jo më vonë se 50 ditë nga data e zgjedhjeve.*

*2. Kandidati i propozuar nga një grup zgjedhësish nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurren në atë zonë zgjedhore dhe as të mbështesë haptazi apo në mënyrë të tërthortë ndonjë subjekt apo kandidat tjetër që konkurren në atë zonë zgjedhore.*

**3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondojnë 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod.**

**4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësisia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit”.**

6. Për aq kohë sa KZAZ Nr. 90, në arsyetimin e vendimmarrjes së saj, ka argumentuar se moskrijimi i komitetit nismëtar është shkak i vetëm i mospranimit për regjistrim të kandidatit Mehmet Nelaj, pavarësisht faktit se ai zotëron një mandat në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Sarandë që me zgjedhjen e tij në zgjedhjet e datës 30 qershor 2019, në rastin objekt shqyrtimi administrativ, shtrohen për zgjidhje pyetjet e mëposhtme:

**- Cili është funksioni i komitetit nismëtar në zbatim të nenit 70 pika 3 të K.Zgjedhor?**

- A barazohet “kandidati i propozuar nga zgjedhësit” në zbatim të K.Zgjedhor në fuqi me “kandidatin e pavarur” në kuptim të K.Zgjedhor të miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 (i shfuqizuar tashmë)?

- A është kusht i domosdoshëm krijimi një komitet nismëtar në rastin që qëllimi i këtij komiteti nismëtar është propozimi si kandidat i një shtetasi që zotëron mandat në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore që do të kandidojë sërish?

7. Në lidhje me pyetjen e parë, është pika 3 e nenit 70 të K.Zgjedhor që e përcakton qartazi funksionin e komitetit nismëtar, duke parashikuar se **“3. Për paraqitjen e kandidatit nga zgjedhësit krijohet një komitet nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës nga zona zgjedhore përkatëse, të cilët janë të ngarkuar për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin. Jo më vonë se 70 ditë para datës së zgjedhjeve, komiteti nismëtar regjistrohet në KZAZ, duke paraqitur emrat e anëtarëve të komitetit. Komiteti mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë vetëm nëse ka marrë mbështetje për kandidatin nga një numër zgjedhësish që i korrespondon 1 për qind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, por, në çdo rast, jo më pak se 50 zgjedhës, sipas procedurave të përcaktuara në këtë Kod”**.

Nga vetë dispozita rezulton se komiteti nismëtar, së pari është i ngarkuar me mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin dhe së dyti, nëse arrin të mbledhë 1 përqind të listës së zgjedhësve të zonës zgjedhore, atëherë mund të regjistrojë një kandidat për kryetar të bashkisë ose për anëtar të këshillit bashkiak. **Duket qartë që qëllimi i krijimit të komitetit nismëtar është vetëm ai i mbledhjes së firmave mbështetëse.**

8. Qëllimi i komitetit nismëtar del dhe nga interpretimi i pikës 4 të po të njëjtit nen ku parashikohet se **“4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni, nëse janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse ose deputetë. Në këtë rast kandidati paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësisia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit”**. Përveç fjalisë së parë që qartazi nënkupton se në rastin e zotërimit të mandatit, nuk mblidhen firma mbështetëse për kandidatin, është fjalia e dytë ajo që e qartëson më tej edhe moskrijimin e komitetit



nismëtar, pasi ligjvënësi, paraqitjen e vërtetimit me shkrim të nënshkruar nga njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit, i'a ngarkon kandidatit dhe jo komitetit nismëtar. Atëherë me të drejtë mund të ngremë pyetjen se përse duhet krijuar një komitet nismëtar kur kandidati nuk e ka detyrim mbledhjen e firmave për atë kohë sa zotëron një mandat?! Nëse qëllimi i ligjvënësit do ishte vetëm për përjashtimin e mbledhjes së nënshkrimeve dhe jo edhe për përjashtimin e krijimit të komitetit nismëtar, atëherë pika 4 do të ishte formuluar ndryshe, si p.sh.:

- "4. Kandidatët e propozuar nga zgjedhësit përjashtohen nga detyrimi **për mbledhjen e firmave mbështetëse** i parashikuar në pikën 3 të këtij neni ..."; ose

- "... Në këtë rast **komitetit nismëtar** paraqet një vërtetim me shkrim, të nënshkruar nga institucioni i Kuvendit apo njësia e qeverisjes vendore, ku vërtetohet zotërimi i mandatit të paktën 6 muajt e fundit".

9. Në lidhje me pyetjen e dytë, nëse barazohet "kandidati i propozuar nga zgjedhësit" në zbatim të K.Zgjedhor në fuqi me "kandidatin e pavarur" në kuptim të K.Zgjedhor të miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 (i shfuqizuar tashmë), do i referohemi përkufizimeve sipas secilit prej kodeve zgjedhore. Në K.Zgjedhor në fuqi, neni 2 pika 3 e tij e përkufizon "kandidatin e paraqitur nga një grup zgjedhësish" si "... një kandidat për deputet ose për kryetar bashkie, ose për këshillin e bashkisë, **që nuk mbështetet nga asnjë parti politike dhe që propozohet nga zgjedhësit, në përputhje me këtë Kod**". Në K.Zgjedhor të miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003, neni 2 pika 4 e tij e përkufizon "kandidatin e pavarur" si "... një kandidat për deputet ose për kryetar bashkie a komune, ose për këshillin e bashkisë a të komunës, **që nuk mbështetet nga asnjë parti politike**".

10. Ajo çka kanë të përbashkët të dy përkufizimet është dhe elementi thelbësor i këtij subjekti zgjedhor, ai që nuk mbështeten nga asnjë parti politike, pra në thelb, si kandidati i pavarur, ashtu dhe ai që paraqitet nga një grup zgjedhësish, nuk kanë mbështetjen e ndonjë partie politike. Po ashtu, edhe elementi i mbledhjes së firmave është i përbashkët si për kandidatin

e pavarur<sup>1</sup>, ashtu edhe për atë që paraqitet nga një grup zgjedhësish<sup>2</sup>, por edhe përjashtimi nga mbledhja e firmave vlen si për kandidatin e pavarur<sup>3</sup> ashtu dhe për atë të paraqitur nga një grup zgjedhësish<sup>4</sup>.

11. Për sa më sipër, vlen për t'u arsyetuar dallimi i vetëm që kanë këto dy nocione kandidimi, ku kandidati i pavarur rezulton të ketë kuptimin e vetëkandidimit, ndërkohë që kandidati i paraqitur nga një grup zgjedhësish rezulton që të jetë propozim i një komitetit nismëtar me jo më pak se 9 zgjedhës. Pavarësisht këtij dallimi sintaksor, po t'i referohemi praktikës së Gjykatës Kushtetuese, duket se ajo i trajton njësoj të dy konceptet, pasi në vendimin nr. 28, datë 09.05.2012 të saj, vetë Gjykata Kushtetuese i përdor termat "*kandidat i propozuar nga një grup zgjedhësish*" dhe "*kandidat i pavarur*" si sinonime. Më konkretisht, në pikën 12 të vendimit, ndër të tjera, citohet se "*Në lidhje me nenin 69 të Kodit Zgjedhor, Gjykata vëren se ai rregullon procedurën për regjistrimin në zgjedhjet e përgjithshme të **kandidatit të propozuar nga një grup zgjedhësish**, duke parashikuar se ky subjekt zgjedhor nuk mund të jetë pjesë e asnjë partie apo koalicioni që konkurron në zgjedhje. Në kushtet kur kjo dispozitë, në ndryshim nga neni 70 i Kodit Zgjedhor, shprehet vetëm për **kandidatët e pavarur** dhe nuk bën asnjë rregullim për kandidatët e partive politike, qofshin ato parti parlamentare ose jo, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për kundërshtimin e saj, pasi ajo nuk rregullon, dhe në këtë mënyrë as nuk prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë veprimtarinë e partisë politike si subjekt zgjedhor*".

12. Duke qenë se kemi të bëjmë me të njëjtin nocion, pavarësisht faktit se kandidati i pavarur duket si i vetëkandiduar dhe kandidati i paraqitur nga një grup zgjedhësish duket si i propozuar, në të dyja rastet përputhet vullneti i vetë kandidatit për të kandiduar si i pambështetur nga ndonjë parti politike. Për këtë arsye, funksioni i komitetit nismëtar, siç del dhe nga interpretimi literal i dispozitës, është ai i mbledhjes së firmave mbështetëse për kandidatin, një funksion burokratik, çka nuk e ndryshon statusin e kandidatit të paraqitur nga

<sup>1</sup> Neni 81 pika 2 e K.Zgjedhor të miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003

<sup>2</sup> Neni 70 pika 3 e K.Zgjedhor

<sup>3</sup> Neni 81 pika 4 e K.Zgjedhor të miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003

<sup>4</sup> Neni 70 pika 4 e K.Zgjedhor

një grup zgjedhësish nga statusi i kandidatit të pavarur. **Për rrjedhojë, përgjigjja e pyetjes së dytë është se “kandidati i propozuar nga zgjedhësit” në zbatim të K.Zgjedhor në fuqi, barazohet me “kandidatin e pavarur” në kuptim të K.Zgjedhor të miratuar me ligjin nr. 9087, datë 19.06.2003 (i shfuqizuar tashmë).**

13. Në lidhje me pyetjen e tretë, nëse është kusht i domosdoshëm krijimi një komitet nismëtar në rastin që qëllimi i këtij komiteti nismëtar është propozimi si kandidat i një shtetasi që zotëron mandat në të njëjtën njësi të qeverisjes vendore që do të kandidojë sërish, është e rëndësishme që kuptimi i nenit 70 të K.Zgjedhor të trajtohet sipas interpretimit historik dhe atij teleologjik.
14. Sipas interpretimi historik, ne anëtarët në pakicë, për aq kohë sa arritëm në përfundimin që kandidati i propozuar nga zgjedhësit, barazohet në status me kandidatin e pavarur, atëherë në rastin kur kandidati i pambështetur nga ndonjë parti politike ka një mandat në këshillin bashkiak përkatës dhe nuk ka detyrim për ta mbështetur kandidimin me mbledhje firmash, atëherë ai duhet të trajtohet njësoj si kandidati i pavarur – **mjafton që të depozitojë vërtetimin me shkrim në lidhje me zotërimin e mandatit të paktën 6 muajt e fundit dhe për rrjedhojë nga KQZ/KZAZ duhet të regjistrohet si subjekt zgjedhor në përputhje me nenin 70 të K.Zgjedhor.**
15. **Sipas interpretimit teleologjik, për aq kohë sa komiteti nismëtar krijohet për mbledhjen e firmave mbështetëse për kandidatin dhe mund të ketë në përbërjen e tij jo më pak se 9 zgjedhës, e bën të palogjikshëm krijimin e tij vetëm për të administruar vërtetimin e zotërimit të mandatit nga kandidati, aq më tepër që pika 4 e nenit 70 të K.Zgjedhor ngarkon vetë kandidatin për paraqitjen e vërtetimit me shkrim për zotërimin e mandatit.**
16. Gjithashtu vlen për t’u theksuar se gjatë shqyrtimit administrativ në KAS, nga Sekretari i Përgjithshëm i KQZ u pranua se ne zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, janë regjistruar si subjekte zgjedhore, në zbatim të nenit 70 të K.Zgjedhor, kandidatë të propozuar nga zgjedhësit që zotëronin një mandat, pa regjistruar më parë një

komitet nismëtar. Një nga këto raste ka qenë dhe z. Mehmet Nelaj, që në bazë të të njëjtës dispozitë të K.Zgjedhor, në vitin 2019 është regjistruar pa krijuar një komitet nismëtar, për shkak të faktit se e zotëronte mandatin në Këshillin Bashkiak Sarandë nga zgjedhjet vendore të vitit 2015. Për aq kohë sa ankimuesi Mehmet Nelaj, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor nëpërmjet të njëjtit dokumentacion (pa krijuar paraprakisht një komitet nismëtar) si ai i depozituar për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, pritshmëria legjitime e tij është ajo e regjistrimit si subjekt zgjedhor edhe në këto zgjedhje. Mosregjistrimi i tij për shkak të moskrijimit të komitetit nismëtar, do të cënonte parimin kushtetues të sigurisë juridike. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, më konkretisht në vendimin nr. 43, datë 06.10.2011, ka arsyetuar ndër të tjera se:

*“35. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si **dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elementë të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme. Rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen interesa dhe pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasojë pozitive, konkretisht trajtim më të mirë financiar për subjektet përfituese”.***

Në rastin objekt shqyrtimi administrativ, ankimuesit Mehmet Nelaj i është mohuar një pritshmëri e ligjshme e tij pa ndryshuar legjislacioni, por vetëm nëpërmjet interpretimit që anëtarët aktual të KZAZ i kanë bërë nenin 70 të K.Zgjedhor.

17. Po ashtu, ne anëtarët në pakicë, konstatojmë se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka nxjerrë Udhëzimin nr. 1, datë 18.01.2023 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, nëpërmjet të cilit, me interpretim të zgjeruar, komitetin nismëtar e konsideron si kusht *sine qua non* për regjistrimin e një kandidati që zotëron mandat në këshillin bashkiak sipas nenit 70 pika 4 të K.Zgjedhor. Neni 6 pika 2 shkronja “g” e këtij udhëzimi është interpretim i gabuar dhe kufizues i K.Zgjedhor dhe për rrjedhojë një e drejtë që njihet nga ky i fundit, nuk mund të kufizohet me akt nënligjor, siç është përjashtimi që neni 70 pika 4 e K.Zgjedhor bën specifikisht për krijimin e komitetit nismëtar.

18. Për sa më sipër, ne anëtarët në pakicë vlerësojmë se kërkesa ankimore e paraqitur nga ankimesi Mehmet Nelaj është e bazuar në ligj dhe ajo duhej të ishte pranuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, ndërkohë që duhet të ishte shfuqizuar vendimi nr. 17, datë 27.03.2023 i KZAZ Nr. 90 dhe duhet të detyrohej kjo e fundit që të regjistronte si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak z. Mehmet Nelaj të propozuar nga zgjedhësit për Bashkinë Sarandë.

**Koli BELE** - **Relator**

**Ledio BRAHO** - **Anëtar**